

Programi i Unionit Evropian "IPA II" për "Kosovën"

Produkti P1.1.1

RAPORTI I VLERËSIMIT TË SHPEJTË DHE LETRA REKOMANDUESE

"Lëvizja Përpara":

Promovimi i efikasitetit dhe efektivitetit më të madh në
luftë kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Kosovë"



Projekt i Financuar nga BE dhe i
menaxhuar nga zyra e BE në Kosovë



Projekt i implemetuar nga
**Family and Childcare
Centre (KMOP)**



Kontrata Nr:
2016/382-826

Raporti i Vlerësimit të Shpejtë dhe Letra Rekomanduese



INSTRUMENTI PËR ASISTENCË PARA PRANIMIT (IPA II)
Vija Buxhetore: BGUE-B2014-22.020101-C1-ELARG DELKOS

Referenca: EuropeAid/150787/DD/ACT/XK

**“LËVIZJA PËRPARA: PROMOVIMI I EFIKASITETIT DHE EFEKTIVITETIT
MË TË MADH NË LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE
NË KOSOVË”**

NUMRI I KONTRATËS: 2016/382-826

Produkti P1.1.1

Raport i vlerësimit të shpejtë mbi nevojat për ndërtimin e kapaciteteve të akterëve Anti-trafikim nga këndi i krijimit të Grupit të Trajnerëve

Informata për Dokumentin

Data e caktuar e dorëzimit	30/06/2017
Data e dorëzimit aktual	30/06/2017
Emri i organizatës dhe kontraktorit Lider për këtë produkt	KMOP
Revizioni	2.0

Niveli i Shpërndarjes

PU	Publik	X
PP	I Kufizuar për pjesëmarrësit e programit (përfshirë shërbimet e komisionit)	
RE	I Kufizuar për grupin e specifikuar nga Konzorciumi (përfshirë shërbimet e komisionit)	
CO	Konfidencial, vetëm për anëtarët e konzorciumit (përfshirë shërbimet e komisionit)	

Lista e Autorëve	
Autor	Partner
Nehare Zeqiraj	KMOP
Blerta Perolli-Shehu	KMOP
Rishikuesit	
Rishikuesi	Partner
Antonia Torrens	KMOP
Vassia Karkantzou	KMOP
Effie Lyrissi	EPLO
Alexandra Koufouli	EPLO
Hamijet Dedolli	PVPT
Floriana Ferri	PVPT
Verzioni	
Verzioni	Përmbledhja
1.0	Zhvillimi i draft verzionit v01
2.0	Verzioni Final

Projekti është i financuar me përkrahjen me e Komisionit Evropian.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorit, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si reflektim i pikëpamjeve të Bashkimit Evropian

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES	4
LISTA E SHKURTESAVE	5
1. PËRMBLEDHJA	6
2. HYRJE	8
3. INFORMATA MBI FUSHËN	8
4. METODOLOGJIA	11
5. ZBULIMET	15
Çështja kyçe 1: Ka nevojë për ndërtimin e kapaciteteve në planifikim strategjik si dhe në mekanizmat e M&V	15
Çështja kyçe 2: Ka nevojë për përmirësimin e angazhimit koordnimit të akterëve.....	16
Çështja kyçe 3: Ka nevojë për krijimin e grupit të trajnerëve të aftë për të ofuar trajnime për akterët lokal nën koordinim të KNAT/ZKNAT	17
6. KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET	18
7. ANEX 1: DRAFT PROGRAMI I TRAJNIMIT	18

LISTA E SHKURTESAVE

Shkutesa	Kuptimi
AT	Anti-Trafikim
OSHC	Organizata e Shoqërisë Civile
Tabela e stilit të përmbajtjes	Table Content Style
EPLO	Organizata Evropiane për Ligjin Publik
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
KMOP	Qendra për Kujdes të familjes dhe Fëmijëve
M&V	Monitorimi dhe Vlerësimi
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
KNAT	Koordinatori Nacional për Anti-Trafikim
MNR	Mekanizmi Nacional Referues
ZKNAT	Zyra e Koordinatorit Nacional për Anti-Trafikim
PVPT	Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe parandalimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore
PSV	Procedurat Standarde të Veprimit
TQNJ	Trafikimi i Qenieve Njerëzore
VNT	Vlerësimi i Navojave të Trajnimit
TiT	Trajnimi i Trajnerëve
MTR	Mekanizmi Transnacional Referues
VeT	Viktimat e Trafikimit
WINPRO	Programi i Mbrojtjes së Viktimave

1. PËRMBLEDHJA

Qëllimi i këtij Vlerësimi të Nevojave të Trajnimit (VNT) është të vlerësojë nevojat për ngritjen e kapaciteteve të institucioneve kryesore përgjegjëse për koordinimin e përpjekjeve antitrafik në Kosovë, përkatësisht të Koordinatorit Nacional Antitrafikim (KNAT) dhe zyrën e tij (ZKNAT) dhe duke u zgjeruar me pjesëtarë të Autoritetit Nacional Antitrafikim, për të udhëhequr zhvillimin e një plani relevant për ndërtimin e kapaciteteve dhe programin e trajnimit që do të realizohet gjatë implementimit të projektit në përputhje me Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit kundër Trafikimit në Qenie Njerëzore 2015-2019.

Përmes këtij VNT kemi grumbulluar informacionin e nevojshëm dhe kemi vlerësuar nevojat për ngritjen e kapaciteteve me qëllim të vlerësimit të nevojave të KNAT / ZKNAT nga njëra anë dhe nga ana tjetër, të hartimit të programit Trajnimi i Trajnerëve (TiT) për krijimin e një grupi trajnerësh për të forcuar zbatimin e politikës antitrafikim dhe masave të ndërlidhura dhe për të mbështetur në të ardhmen punën e KNAT / ZKNAT në ndërtimin e kapaciteteve të palëve kyçe të antitrafikimit në përputhje me trendet dhe zhvillimet në terren. Qëllimi kryesor i kësaj iniciative është trajnimi i Mekanizmit Nacional të Referimit (MNR) dhe zbatimit të Procedurave Standarde të Veprimit (PSV). Ndërtimi i kapaciteteve do të ketë ne objektiv nivelin kombëtar - duke synuar forcimin e mekanizmave të koordinimit dhe implementimit të akterëve (sundimi i ligjit, palët e interesit për parandalim dhe mbrojtje) që merren me çështjet e trafikimit, përmirësojnë integrimin afatgjatë të VT, përmirësojnë standardet në zbatimin adekuat të Strategjisë Kombëtare Anti-trafikim dhe Planin e Veprimit 2015-2019, si dhe funksionimin e Mekanizmit Nacional të Referimit (MNR) dhe zbatimin e PSV-ve.

Vlerësimi i nevojave për ngritjen e kapaciteteve për KNAT / ZKNAT është realizuar në konsultim të ngushtë (takime dhe intervista) me palët kyçe të cilët janë anëtarë të Autoritetit Nacional Antitrafikim, sikurse, me vet strukturën e KNAT/ZKNAT dhe me anëtarët e tjerë si dhe përmes hulumtimeve në vend pune me qëllim të vlerësimit të boshllëqeve të mundshme në aftësi dhe njohuri, si dhe fuqinë e palëve relevante të interesit për të udhëhequr zhvillimin e një programi gjithëpërfshirës të trajnimit.

VNT ka identifikuar boshllëqet në aftësitë e planifikimit strategjik dhe të zhvillimit të strategjisë, të cilat kërkojnë veprime drejt KNAT dhe ZKNAT në mënyrë specifike, pasi ato kanë një implikim të drejtpërdrejtë në strategjinë tjetër.

Mangësitë janë identifikuar gjithashtu në mekanizmat për mbledhjen e të dhënave dhe mekanizmat e përdorur të monitorimit.

Bazuar në vlerësimin e kryer, janë identifikuar tri çështje kyçe:

1. Ekziston nevoja për ngritjen e kapaciteteve në planifikimin strategjik, si dhe mekanizmat e M&V
2. Ekziston nevoja për të përmirësuar angazhimin dhe koordinimin e palëve të interesit

3. Ekziston nevoja për të krijuar një grup trajnerësh të aftë për të ofruar trajnime për palët e interes në nivel lokal nën koordinimin e KNAT / ZKNAT

Gjetjet dhe konkluzionet e nxjerra në këtë dokument janë përdorur për zhvillimin e një drafti të Programit të Trajnimit, i cili është i ofruar në Aneksin 1. Draft Programi i Trajnimit.

2. HYRJE

Qëllimi i këtij Vlerësimi të Nevojave të Trajnimit (VNT) është të vlerësojë nevojat për ngritjen e kapaciteteve të palëve kryesore antitrafikim dhe veçanërisht të Koordinatorit Nacional Antitrafikim (KNAT) dhe Zyrës së tij (ZKNAT), për të udhëhequr zhvillimin e një plani përkatës për ndërtimin e kapaciteteve dhe programin e trajnimit në përputhje me Strategjinë Nacionale dhe Planin e Veprimit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2015-2019. Ky VNT zhvillohet në kuadër të projektit të financuar nga BE-ja "Lëvizja përpara - Promovimi i efikasitetit dhe efektivitetit më të madhë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Kosovë", implementuar nga Qendra për përkujdesje familjare dhe fëmijë (KMOP) në bashkëpunim me EPLO (GR) dhe Qendrën për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore (PVPT) në Kosovë (financuar nga Zyra e BE-së në Kosovë). Projekti filloi në Janar 2017 dhe do të zgjasë deri në Janar 2020 me objektivin e përgjithshëm për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të luftës kundër trafikimit me qenie njerëzore (TQNJ) në Kosovë duke rritur aftësinë e institucioneve të Kosovës për të koordinuar dhe implementuar në mënyrë efektive të gjitha masat kundër -TQNJ, në përputhje me praktikat më të mira të BE-së dhe prioritetet e përgjithshme të zhvillimit të Kosovës

Siç është theksuar në raportin fillestar të projektit, ekziston nevoja për të zhvilluar trajnime të përbashkëta të akterëve kryesorë (policia, avokatët e viktimave, punonjësit socialë, prokurorët, gjyqtarët dhe ofruesit e strehimit) të përfshirë në Mekanizmin Nacional të Referimit (MNR) me qëllim të forcimit të reagimit institucional ndaj trafikimit me qenie njerëzore, përmirësimi i zbatimit të PSV-ve dhe përmirësimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstytucional. Bazuar në kontributin e marrë në fazën fillestare të projektit, mënyra optimale për ta arritur këtë është përmes krijimit të një grupi trajnerësh, të cilët do të marrin rolin qendror në trajnimin e mëtejshëm të akterëve lokalë dhe profesionistëve të përfshirë drejtpërdrejt ose tërthorazi në fushën kundër trafikimit. Për këtë arsye, është propozuar që të adresohen nevojat afatgjata të ndërtimit të kapaciteteve të anëtarëve të Autoritetit Kombëtar përmes shpërndarjes së programit Trajnimi i Trajnerëve (TiT) për një grup të vogël trajnerësh që do të përzgjidhen në bashkëpunim me KNAT dhe zyrën e tij. Duhet theksuar se ofrimi i Programit duhet të planifikohet duke pasur parasysh zhvillimin e planifikuar të produkteve të tjera relevante të projektit, siç janë PSV-të transnacionale.

Puna e ndërmarrë në kryerjen e këtij VNT u përqendrua në identifikimin e të dy faktorëve, forcës dhe nevojave të palëve kryesore të antitrafikimit dhe kompetencat kyçe të KNAT / ZKNAT me qëllim të zhvillimit të një programi efektiv për ngritjen e kapaciteteve që do të ndërtonte kapacitetin e duhur për të implementuar Strategjinë Nacionale. Prandaj, zëri i akterëve të ndryshëm është thelbësor në ndërtimin e përmbajtjes së programit të trajnimit që do të pajisë grupin e trajnerëve me aftësitë, njohuritë dhe qëndrimet ndaj trajtimit të çështjeve të AT dhe në mënyrë efektive dhe efikase të luftimit të TQNJ në Kosovë. Prioritetet e identifikuar nga VNT, së bashku me kontributin e akterëve të tjerë kryesorë dhe informatave mbi aktivitetet e synuara të trajnimit do të përfshihen në planin e trajnimit. Një draft i Planit të Trajnimit është prezantuar në Aneksin 1 duke u bazuar në konkluzionet dhe rekomandimet e paraqitura në kapitullin 6- Konkluzionet dhe Rekomandimet

3. INFORMATA MBI FUSHËN

Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore është një prioritet kyç i Qeverisë në Kosovë dhe një nga parakushtet kryesore për pranimin në BE. Kjo është reflektuar në Strategjinë e fundit Nacionale kundër TQNJ (Strategjia Kombëtare 2015-2019) e cila qartë tregon se trafikimi është shkelje e të drejtave të njeriut dhe një nga format më agresive të krimit të organizuar që minon shoqërinë kosovare. Dinjiteti njerëzor renditet si një nga vlerat themelore të njeriut në aktin më të lartë juridik, Kushtetutën e Republikës së Kosovës, prandaj institucionet e Republikës së Kosovës janë të përkushtuara që të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar këtë vlerë në mënyrë efektive, dhe përveç kësaj, për të mbrojtur popullin e Kosovës nga dukuria negative e trafikimit të qenieve njerëzore dhe gjithashtu për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e njeriut për të gjitha viktimat e trafikimit, pavarësisht racës, përkatësisë etnike apo gjinisë (Strategjia Kombëtare 2015-2019).

Struktura e KNAT dhe Zyrës përkatëse (ZKNAT) u prezantua në Tetor të vitit 2003, duke përkuar me shpalljen e vendimit për themelimin e grupit të parë punues ndërmarror kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Kosovë në nivel nacional. Ky grup punues është themeluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 9.3.1 nr. 2001/9 të Kornizës Kushtetuese / Institucioneve të Përkohshme Qeverisëse të Kosovës. Për herë të parë u emërua Kryetari Nacional i grupit punues të Antitrafikimit dhe kjo përgjegjësi e detyrueshme u delegua në Zyrën për Qeverisje të Mirë nën Zyrën e Kryeministrit. Grupi punues u mandua të hartojë për herë të parë Raportin mbi gjendjen e trafikimit të qenieve njerëzore në Republikën e Kosovës

Në Dhjetor të vitit 2004, Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit të Kosovës i dorëzoi shefit të Misionit të IOM-it notën zyrtare se Sekretariati Nacional për Koordinatorin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore është themeluar.

Në Maj të vitit 2005, Qeveria e Kosovës caktoi drejtorin e Zyrës për Qeverisje të Mirë si Koordinator Nacional për Anti-Trafikim në Republikën e Kosovës dhe mandati i parë i KNAT / ZKNAT u formalizua në bazë të nenit 9.3.16 të UNMIK-ut Rregullorja nr. 2001/9 të Kornizës Kushtetuese / Institucioneve të Përkohshme Qeverisëse të Kosovës, neni 1 i Rregullores së UNMIK-ut nr.2001 / 19.

Në vitet e fundit, një nga arritjet më të rëndësishme në fushën e anti-trafikimit ka qenë miratimi i Ligjit të vitit 2013 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikuara, që parashikon për një numër të madh institucionesh dhe mekanizmash të Kosovës kompetent për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe sigurimin e ndihmës dhe mbrojtjes për viktimat e trafikuar. Për të dhënë një pamje më të mirë të fushës antitrafikim në Kosovë, më poshtë do të paraqesim elementët kryesorë të mekanizmit antitrafikim në Kosovë, siç përcaktohet me Ligjin nr. 04 / I-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, i cili përfshin Koordinatorin Nacional të Anti-Trafikimit, Zyrën e tij (ZKNAT) i njohur gjithashtu si Sekretariati për Monitorimin dhe Vlerësimin e Strategjisë Nacionale (ose thjesht Sekretariati AT) dhe Autoriteti Kombëtar AT me anëtarët e tij.

Në pajtim me nenin 8 të Ligjit nr. 04 / L-218, qeveria emëron Koordinatorin Nacional Anti-Trafikim, i cili kryeson Autoritetin Nacional. Si në praktikat e kaluara, Koordinator është Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, i cili është emëruar së fundmi më 6 tetor 2015. Koordinator bashkëpunon vazhdimisht me institucionet e Autoritetit Nacional dhe me autoritetet e tjera të zbatimit të ligjit me qëllim parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore si dhe për të mbrojtur personat e trafikuar. Koordinator, me mbështetjen e Sekretariatit për Monitorimin dhe Vlerësimin e Strategjive Nacionale, i cili funksionon në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, zhvillon, koordinon dhe monitoron zbatimin e mekanizmit kombëtar të referimit për të siguruar identifikimin, referimin, ndihmën dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, duke përfshirë fëmijët viktimë, dhe për të siguruar që ata marrin ndihmë adekuate duke mbrojtur të drejtat e tyre njerëzore.

Sekretariati Anti-trafikim, si ZKNAT, është përgjegjës për mbledhjen e informatave dhe të dhënave nga institucionet e tjera për zbatimin e Strategjisë Nacionale kundër Trafikimit, si dhe analizimin dhe vlerësimin e këtyre informatave. Përgatit raporte analitike për Koordinatorin Nacional i cili monitoron dhe vlerëson performancën e aktiviteteve që rrjedhin nga Planit i Veprimit të Strategjisë. Propozon ndryshime dhe përmirësime në sistemin dhe mekanizmat e Strategjisë Nacionale nëpërmjet Koordinatorit Nacional dhe e këshillon atë për hapat që duhen ndërmarrë për zbatimin e Strategjisë, inkurajon rritjen e transparencës së veprimtarisë së institucioneve shtetërore të përfshira në Strategjinë Nacionale kundër Trafikimit, duke bashkëpunuar me institucionet e tjera dhe shoqërinë civile dhe duke ofruar shërbime teknike administrative për Ekipin Ndërinstitucional të Strategjisë.

Aktualisht ZKNAT përbëhet nga gjithsej 4 persona - Koordinatorin Nacional, Ndihmësi i tij, Drejtori i Departamentit të Strategjive dhe Zyrtari i Lartë për Anti-Trafikim.

Autoriteti Nacional për Anti-Trafikim është një mekanizëm i themeluar me Ligjin nr. 04 / L-218, dhe përbëhet nga të gjitha institucionet e përcaktuara në nenin 6 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikuara, si dhe institucionet tjera relevante shtetërore, duke përfshirë përfaqësuesit e ofruesve të shërbimeve vendore si ato Qeveritare ashtu dhe Organizatat Joqeveritare. Autoriteti Nacional, në kuadër të Strategjisë Nacionale dhe Planit të Veprimit kundër Trafikimit të Njerëzve, Procedurave Standarde të Veprimit për viktimat e trafikimit, standardeve minimale të kujdesit për viktimat e trafikimit dhe të gjitha dokumenteve të tjera përkatëse, përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e secilit institucion në parandalimin dhe luftimin e TQNJ dhe mbrojtjen e viktimave për të mundësuar luftën efektive kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe ndihmën me kohë dhe në mënyrë efektive në mbrojtjen e viktimave të dhunës në Kosovë, siç përcaktohet nga mandati legjislativ i secilit institucion. Institucionet që janë anëtare të Autoritetit përfshijnë Ministrinë e Punëve të Brendshme, Policinë e Kosovës, Ministrinë e Drejtësisë, Gjykatat, Prokurorin e Shtetit, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shoqërinë Civile, Donatorët, etj. Autoriteti takohet periodikisht dhe në bazë të nevojave ad-hoc. Egzistojnë nëngrupe të themeluara dhe të organizuara sipas natyrës së çështjeve të eksploruara ose të diskutuara.

Në përputhje me përgjegjësitë e ZKNAT, zyra zhvillon, koordinon dhe monitoron zbatimin e mekanizmit Nacional të referimit për të siguruar identifikimin, referimin, ndihmën dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, duke përfshirë fëmijët viktima, si dhe për të siguruar që ata të marrin ndihmë adekuate dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre njerëzore. Si zyrë e KNAT, ZKNAT është forca shtytëse për implementimin e reagimit kombëtar kundër trafikimit duke kryer koordinimin e përgjithshëm dhe aktivitetet e monitorimit dhe raportimit. Një nga rezultatet kryesore të angazhimit afatgjatë të Kosovës në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore janë Procedurat Standarde të Veprimit për Personat e Trafikuar në Kosovë (PSV), të hartuara së pari në 2004 dhe më vonë të rishikuara dhe të miratuara në vitin 2012. Procedurat e aprovuara Standarde të Veprimit (PSV) për Trafikimin e Personave në Kosovë, ofrojnë udhëzime për të gjithë akterët e përfshirë, nga referimi fillestar deri në procedurat civile ose penale, dhe si të tillë ato drejtojnë akterët shtetëror dhe jo shtetëror të anti-trafikimit mbi mënyrën e sigurimit të mbrojtjes së duhur dhe ndihmës ndaj viktimave të supozuara/mundshme. Aktivitetet e koordinimit, monitorimit dhe raportimit për zbatimin e PSV-ve janë përgjegjësi e ZKNAT-it. Për të përcaktuar se cili institucion apo institucione duhet ndërmarrë rolin e menaxhuesit të rasteve gjatë zbatimit të PSV-ve, u zhvilluan disa shkëmbime informatash me palë të interesuara vendore dhe ndërkombëtare si dhe në Nëntor të vitit 2012 nga Projekti i BE u organizua një takim teknik për diskutim të hollësishëm mbi çështjen e "Menaxhimit të Rasteve". Në bazë të marrëveshjes ndërmjet anëtarëve të IMËG-së, PSV parasheh emërimin e punonjësve socialë të Qendrave të Punës Sociale (QPS) si menaxherë të rasteve për fëmijët e trafikuar dhe Zyra Rajonale për Avokim dhe Ndihmë Viktimave si menaxhues të rasteve për të rriturit e trafikuar. Menaxherët e rasteve ndihmojnë shtetasit lokal dhe të huajt.

Që nga themelimi i Zyrës, shumë organizata kanë ofruar ngritjen e kapaciteteve të institucioneve nacionale dhe lokale duke përfshirë ofruesit e shërbimeve të shoqërisë civile. Një pjesë e rëndësishme e aktiviteteve të zbatuara të ndërtimit të kapaciteteve në parim është në kontekstin e projekteve ndërkombëtare (të financuara nga donatorët). Kjo është e lidhur edhe me faktin se nuk ka pasur qasje sistematike dhe të strukturuar në zhvillimin e burimeve njerëzore në fushën e AT, duke përfshirë burimet e qëndrueshme me një grup të trajnerëve lokalë me mandat për të mbështetur KNAT / ZKNAT në luftën kundër trafikimit nëpërmjet forcimit të kapaciteteve në mesin e akterëve lokalë për të luftuar TQNJ dhe projektin për VeT. Vlerësimet e nevojave për trajnim të kryera nga projektet e hershme identifikuan dobësi në kompetencat strategjike dhe koordinuese të hartuesve të politikave, menaxherëve dhe stafit operativ, të pasuara nga burime joadekuate njerëzore, financiare dhe material.

Sipas raporteve të progresit të Strategjisë Nacionale, rritja e vazhdueshme e kapaciteteve të institucioneve të Kosovës të përfshira në zhvillimin dhe zbatimin e kuadrit strategjik në këtë fushë tregon se janë bërë përpjekje të konsiderueshme. Programi i Qeverisë së Kosovës ndaj kësaj është vendosur nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut, duke konsideruar fenomenin e trafikimit njerëzor si një shkelje të të drejtave themelore të njeriut

Duke krahasuar raportet e KNAT / ZKNAT nga viti 2015 dhe 2016, ka një numër në rritje të viktimave të identifikuara të trafikimit, si dhe një numër në rritje të viktimave nën moshën 18 vjeç. Ka gjithashtu

tregues se ka një rënie të viktimave të huaja dhe një rritje e konsiderueshme e viktimave lokale. Megjithatë, në procesin e kryerjes së këtij VNT, në sistemin e grumbullimit të të dhënave u identifikuan boshllëqe që pasqyrojnë edhe trendet e paraqitura në raport. Një nga zbrazëtitat kryesore del nga regjistrimi i viktimave të cilat janë përsëritur si viktima të reja, gjë që rezultoi me mungesën e të dhënave për ri-trafikimin dhe kështu të numrit absolut të rasteve të trafikimit në vend se të incidenteve të trafikimit.

Duhet të theksohet se, për shkak të procesit të fundit politik zgjedhor në Kosovë, mund të zëvendësohet Koordinatori Nacional për Anti-Trafikimin (pozicioni që Zëvendës Ministri i MPB-së aktualisht e mban), në varësi të strukturës së re të qeverisë në vend. Megjithëse kjo nënkupton investim të përpjekjeve shtesë nga ekipi/konsorciumi i projektit në mënyrë që të krijohen marrëdhënie të mira pune edhe me Koordinatorin e ri, ekziston rreziku minimal që të ketë ndonjë ndikim negativ në zbatimin e projektit duke pasur parasysh se personeli i ZKNAT do të mbetet i njëjtë, dhe kështu duke garantuar vazhdimësinë e nevojshme për ofrimin e shërbimeve të planifikuara dhe mbështetjes nga Projekti.

4. METODOLOGJIA

Vlerësimi i nevojave për ngritjen e kapaciteteve të KNAT / ZKNAT dhe anëtarëve të tjerë të Autoritetit Nacional Antitrafikim është zbatuar në konsultim të ngushtë (takimet dhe intervistat) me akterët përkatës. Informacioni është grumbulluar nga shumë burime përmes hulumtimeve në vend pune dhe përmes intervistave me palët kryesore të interesit me qëllim të vlerësimit të nevojave dhe kapaciteteve për të mbështetur zhvillimin e një programi gjithëpërfshirës të trajnimit. Të dhënat e mbledhura gjatë këtij VNT janë përdorur për të shqyrtuar dhe prioritetizuar nevojat e trajnimit të identifikuar nga palët e interesit në përputhje me politikën kombëtare në fuqi. Hapat në mbledhjen e të dhënave ishin si më poshtë

- HAPI 1: Rishikimi dhe analiza e materialeve referuese në dispozicion (03-13 Prill 2017) - të tilla si (përveç dokumenteve të projektit), Ligji kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Strategjia Nationale dhe Plani i Veprimit 2015-2019 kundër TQNJ, Kompensimi i Viktimave, Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Ligji Kundër Diskriminimit në Kosovë, dhe shumë të tjera.
- HAPI 2: Intervistat me palët kyçe të interesit (6 prill-17 maj 2017) (hartuesit e politikave dhe përfaqësuesit e institucioneve që merren me çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore: KNAT dhe ZKNAT, Autoriteti Kombëtar Antitrafikim, MPMS, Mbrojtësit e Viktimave, Këshilli Gjyqësor, Policia e Kosovës/Drejtoria për Hetimin e TQNJ, Strehimorja Shtetërore ISF, Strehimorja e OJQ PVPT, Strehimorja e OJQ-së "Shpresa dhe shtëpitë", dhe akterë të tjerë që nuk janë anëtarë të Autoritetit nacional - Ministria e Drejtësisë/Komisioni për Kompensimin e Viktimave dhe Policia/ Drejtoria për Mbrojtjen e Dëshmitarëve) për të marrë dhe analizuar perspektivat e tyre lidhur me nevojat për ngritjen e kapaciteteve dhe krijimin e grupit të trajnerëve; Për të mbledhur informata për çdo veprim të mëparshëm të ndërtimit

të kapaciteteve; Të identifikohen aftësitë dhe kompetencat e nevojshme, nevojat për trajnim ose mjete të tjera për përmirësimin profesional; Për të prioritetizuar nevojat së bashku me ta.

- HAPI 3: Analizat (03-20 Qershor 2017) i të gjitha informative, dhe
- HAPI 4: Draftimi (20-28 Qershor 2017) raporti i VNT.

Duhet theksuar se në finalizimin e këtij raporti janë ndërmarrë masat e nevojshme të sigurimit të cilësisë dhe janë kërkuar komentet e palëve të interesit në bashkëpunim me Zyrën e BE-së.

LISTA E TAKIMEVE TË MBAJTURA DHE INTERVISTAVE

A/A	Data	Palët (akterët)	Lloji	Qëllimi
1	06/4/2017	Drejtorati për Mbrojtjen e Dëshmitarëve (Ministria e Punëve të Brendshme)	Diskutime konsultative	Vlerësimi i Nevojave për Trajnim
2	07/4/2017	Njësitë Hetimorë të Policisë (Ministria e Punëve të Brendshme)	Diskutime konsultative	Vlerësimi i Nevojave për Trajnim
3	10/4/2017	Komisioni për Kompenzimin e Viktimave (Ministria e Drejtësisë)	Diskutime konsultative	Vlerësimi i Nevojave për Trajnim
4	11/4/2017	Avokatët e Viktimave (Ministria e Drejtësisë)	Diskutime konsultative	Vlerësimi i Nevojave për Trajnim
5	12/4/2017	Këshilli Prokurorial	Diskutime konsultative	Vlerësimi i Nevojave për Trajnim
6	24/04/2017	KNAT/ZKNAT	Diskutime konsultative Individuale	Sfidat me të cilat ballafaqohet personeli i KNAT/ZKNAT në MV dhe mbledhjen e të dhënave
7	26/4/2017	KNAT/ZKNAT	Diskutime konsultative Individuale	Sfidat me të cilat ballafaqohet personeli i KNAT/ZKNAT në MV dhe mbledhjen e të dhënave
8	27/4/2017	KNAT/ZKNAT	Diskutime konsultative Individuale	Sfidat me të cilat ballafaqohet personeli i KNAT/ZKNAT në MV dhe mbledhjen e të dhënave

9	28/4/2017	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	Diskutime konsultative	Vlerësimi i Nevojave për Trajnim
10	28/4/2017	Strehimorja OJQ- PVPT	Diskutime konsultative	Vlerësimi i Nevojave për Trajnim
11	2/5/2017	KNAT/ZKNAT	Diskutime konsultative Individuale	Sfidat me të cilat ballafaqohet personeli i KNAT/ZKNAT në MV dhe mbledhjen e të dhënave
12	3/5/2017	KNAT/ZKNAT & Anëtarët e Autoritetit Nacional	Takim Grupor	Nevojat e përgjithshme për ndërtimin e kapaciteteve, sfidat dhe veprimet e përbashkëta
13	17/5/2017	Strehimoret Shtetërore	Diskutime konsultative	Vlerësimi i Nevojave për Trajnim

5. ZBULIMET (TË GJETURAT)

Çështja kyçe 1: Ka nevojë për ndërtimin e kapaciteteve në planifikim strategjik, si dhe në mekanizmat e M&V

Në luftën kundër TQNJ, nevojitet një qasje strategjike dhe mekanizma të zhvilluar siç duhet për monitorimin dhe vlerësimin e planeve të veprimit dhe zbatimin e politikave dhe strategjive kombëtare të AT. Edhe pse ZKNAT ka zhvilluar këtë qasje, ka hapësirë për përmirësim kur është fjala për cilësinë e objektivave strategjike dhe veprimet e përcaktuara. Në diskutimet me ZKNAT janë ngritur çështje lidhur me mënyrën se si identifikohen objektivat dhe si caktojnë objektivat dhe treguesit kur ata zhvillojnë strategjinë dhe planet e veprimit dhe se si ata vazhdojnë me monitorimin dhe vlerësimin.

Vlerësimi ynë zbuloi se zyra e KNAT ka nevojë për njohuri dhe aftësi shtesë në hartimin dhe planifikimin e strategjisë, shkrimin e raporteve analitike, si dhe monitorim dhe vlerësim, për shkak të vështirësive me të cilat ballafaqohet aktualisht në monitorimin e zbatimit të strategjisë dhe mungesën e mjeteve të besueshme për M & V, në vecanti për vlerësimin periodik të arritjes së objektivave dhe rezultateve. Zyra e KNAT gjithashtu ka nevojë për mbështetje shtesë dhe ngritjen e kapaciteteve në proceset dhe strukturat e menaxhimit dhe udhëheqjes së përgjithshme, veçanërisht në aspektin e koordinimit, që ndikon në mënyrën se si funksionon zyra dhe në mënyrën se si monitorohen proceset. Kjo është pjesërisht për shkak të pozicionit të KNAT, si një pozicion politik që mbulon detyra të tjera përveç KNAT, dhe pjesërisht për shkak të mungesës së mekanizmave të

duhura të M & V. Në këtë respekt, ky ushtrim i VNT solli në sipërfaqe nevojën për të adoptuar një qasje më personale në ndërtimin e kapaciteteve të KNAT dhe veçanërisht të stafit të ZKNAT si një mënyrë më efektive për të zhvilluar njohuri dhe aftësi të qëndrueshme brenda elementit thelbësor të mekanizmit AT.

Siç është përmendur, në përputhje me përgjegjësitë e ZKNAT, zyra zhvillon, koordinon dhe monitoron zbatimin e mekanizmit kombëtar të referimit për të siguruar identifikimin, referimin, ndihmën dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, duke përfshirë viktimat e fëmijëve, si dhe për të siguruar që ata marrin ndihmën adekuate duke mbrojtur të drejtat e tyre njerëzore. Prandaj, një nga çështjet kryesore të identifikuar gjatë diskutimeve me palët e interesuara ishte nevoja për ngritjen e kapaciteteve në zhvillimin dhe menaxhimin e mekanizmave për monitorim dhe vlerësim, si dhe rritjen e mekanizmit të ri për M & V.

Çështja kyçe 2: Ka nevojë për të përmirësuar angazhimin e palëve dhe koordinimin.

Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe lokal për një partneritet të forcuar në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore është një nga objektivat prioritare të Strategjisë Kombëtare AT 2015-2019. Duke e shikuar bashkëpunimin dhe partneritetin lokal, Strategjia Kombëtare AT synon të përmirësojë koordinimin e veprimeve parandaluese dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, në mënyrë që të pakësojë rastet e trafikimit në minimum në Kosovë, si dhe synon të rrisë koordinimin për ofrimin e shërbimeve cilësore për viktimat e trafikimit me qëllim mbrojtjen e dinjitetit të tyre dhe parandalimin e ri-trafikimit të tyre.

Angazhimi dhe bashkërendimi i palëve të interesuara synon të forcon reagimin institucional ndaj trafikimit të qenieve njerëzore, të rrisë zbatimin e PSV-ve dhe të përmirësojë koordinimin midis tyre. Koordinimi i mirë kërkon një qasje të strukturuar dhe sistematike që arrihet përmes takimeve raportuese, konsultimeve, punëtorive, korrespondencës me shkrim, trajnimeve multidisiplinare, trajnimeve të punës, sesioneve konsultative etj. Në luftën kundër TQNJ, institucionet relevante kanë përgjegjësi në koordinimin e punës midis njëri-tjetrit, me përgjegjësi primare për koordinimin që është nën KNAT / ZKNAT.

Gjatë intervistave një-për-një, Zyra e Koordinatorit Nacional / Sekretariati për Anti-Trafikim raportoi mungesë të koordinimit dhe komunikimit ndërmjet palëve të interesit në funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit dhe zbatimin e PSV-ve. Palët e interesit raportuan sfida në grumbullimin dhe shpërndarjen e të dhënave, si dhe në gjenerimin e raporteve të cilësisë së lartë që do të informonin mbi përpjekjet e strukturuar dhe të koordinuara drejt parandalimit dhe luftimit të TQNJ. Gjithashtu, gjatë intervistave me palët e interesit, është raportuar se shpesh ka mungesa të përgjegjësive të caktuara ndërmjet palëve të interesit në drejtim të koordinimit adekuat dhe komunikimit në baza rast- pas - rasti. Siç është duke ndodh tani, një person emërohet nga ZKNAT për të ndjekur procesin e përgjithshëm të mbrojtjes dhe riintegritit të viktimës, duke qenë një pikë e rëndësishme për të gjitha institucionet. Koordinimi midis palëve të interesuara aktualisht po zhvillohet më shumë në

nivelin e shpërndarjes së informacionit, në vend të veprimit të përbashkët në mbrojtje dhe asistencë ndaj viktimës

Prandaj, është identifikuar nevoja për trajnim në aspektet e komunikimit dhe koordinimit të përmirësuar. Ekziston nevoja për të kryer trajnime në drejtim të koordinimit dhe mjeteve të komunikimit për procedurat e përbashkëta dhe të unifikuara të ndjekjes dhe raportimin mbi tendencat e trafikimit.

Gjithashtu, ekziston nevoja për të mbajtur trajnime të akterëve kryesorë të përfshirë në Mekanizmin Nacional të Referimit (MNR) me qëllim të fuqizimit të reagimit institucional ndaj trafikimit të qenieve njerëzore, përmirësimit të zbatimit të PSV-ve dhe përmirësimit të koordinimit ndërmjet tyre, veçanërisht kur është fjala për menaxhimin e rasteve. Versioni i PSV bazohet në menaxhimin e rasteve dhe në parimin e shumë agjencive.

Nga ana tjetër, ky VNT gjithashtu identifikoi një mungesë të vetë-raportuar të njohurive dhe shkathtësive se si të merren me bashkëpunimin transnacional në rastet e trafikimit. PSV-të në fuqi bazohen kryesisht në dokumentin e PSV-ve të vitit 2008, mbi Udhëzimet e MRN-BE për Zhvillimin e një Mekanizmi Transnacional të Referimit për Personat e Trafikuar në Evropë: MRN-EU (2010) nga ICMPD dhe Departamenti Italian për Mundësi të Barabarta¹ dhe të financuara Nga Bashkimi Evropian dhe nga Udhëzimet e MRN-SEE (2009) 2 nga ICMPD dhe financuar nga USAID³. PSV-të e rishikuara në vitin 2012 sigurojnë vetëm procedurat e zbatueshme brenda mekanizmit nacional, por jo për mekanizmin transnacional, prandaj kjo është përfshirë në mandatin e Projektit aktual të BE-së. Prandaj, ekziston nevoja për të përfshirë një komponent të veçantë trajnimi për PSV-të që kanë të bëjnë me Mekanizmin e Referimit Ndërkombëtar (MRN) që Projekti do të zhvillojë në periudhën e ardhshme.

Çështja kyçe 3: ka nevojë për krijimin e një burimi të qëndrueshëm të trajnuesve nacional të aftë për të ofruar trajnime për palët lokale nën koorindimin e KNAT/ZKNAT

Një tjetër pengesë e paraqitur nga palët e interesit ishte mungesa e një burimi të qëndrueshëm të trajnimeve (p.sh. trajnerët nacional) për çështjet e TQNJ. Koordinatorit Nacional dhe Zyrës së tij i janë ofruar disa trajnime nga palët të ndryshme, megjithatë trajnimet janë ofruar kryesisht në baza ad-hoc pa asnjë certifikim ose vazhdimësi në njohuritë e fituara që kanë rezultuar me mungesë të memories institucionale. Ngjashëm është edhe situata me ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve të Autoritetit Nacional dhe akterëve lokalë të AT që kanë marrë kryesisht trajnime klasike (bazike) me një qasje të participimit (pjesëmarrjes).

Në të kaluarën, trajnimi për çështjet e TQNJ u sigurua nga IOM, por në praktikë kjo ishte e bazuar në pjesëmarrje dhe jo në certifikim profesional. Prej atëherë, nuk ka asnjë burim trajnimi standard për KNAT / ZKNAT dhe pjesën tjetër të anëtarëve që kryesisht mbështeten në aktivitetet e organizatave ndërkombëtare dhe projekteve të donatorëve (në veçanti BE) në fushën e të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit. Disa shembuj të mirë mund të raportohen si inkorporimi i trajnimit për gjyqtarë dhe prokurorë që ishin siguruar nga projekti i mëparshëm i Anti-Trafikimit IPA në

planprogramin standard të Institutit Gjyqësor, si dhe trajnimet e certifikuara që EËNPRO ka ofruar edhe pse këto Trajnimet zgjatën vetëm 10 ditë dhe nuk mund të konsiderohen si trajnime të certifikuara dhe të avancuara.

Për të përmbledhur, pothuajse të gjitha programet e trajnimit të ofruara deri më tani, nuk ishin në gjendje të sigurojnë vazhdimësinë e nevojshme të njohurive dhe shkathtësive të gjeneruara / transferuara dhe as që adresonin çështjet e identifikuara në thellësi, por më tepër ishin programe trajnimi që mbulonin ad-hoc dhe në kohë të shkurtër nevojat afatgjata të akterëve të përfshirë në aktivitetet antitrafikim. Kjo u shpreh nga shumica e akterëve të intervistuar (përfshirë MPMS-në, Komisionin për Kompensimin e Viktimave, Strehimoren Shtetërore ISF dhe palët e tjera të interesit nga sektori i OSHC-ve) dhe lidhet me mungesën e një grupi të pajisur mirë të ekspertëve që mund të vepronin si trajnerë nën udhëheqjen e Autoritetit Nacional të AT.

Për të siguruar zbatimin e duhur të MNR dhe PSV, nevojitet një grup i qëndrueshëm i trajnerëve nacional. Ky grup i formuar i trajnerëve do të ketë rol qendror në trajnimin e mëtejshëm të akterëve lokalë dhe profesionistëve të përfshirë drejtpërdrejt ose tërthorazi në fushën e anti-trafikimit. ZKNAT duhet të iniciojë zhvillimin e këtij grupi trajnerësh nga fusha të ndryshme - agjencitë qeveritare, organizatat përkrahëse, organet relevante dhe publikun e gjerë dhe të ofrojnë trajnime të ekspertëve për subjektet e trafikimit të qenieve njerëzore dhe veprimeve dhe aktiviteteve antitrafikim. Këto trajnime duhet të specifikojnë në mënyrë specifike njësitë ose funksionet të cilat mund të vijnë në kontakt me viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore (ose viktima të mundshme), ato duhet të përshtaten me nevojat e këtyre funksioneve dhe të përfshijnë përmbajtjen ligjore, përshkrimin e fenomeneve relevante dhe sigurimin e mjeteve për identifikimin e viktimave të trafikimit dhe skllavërisë.

Njëherë pasi të jetë identifikuar grupi i trajnerëve, para së gjithash ekziston nevoja për të ndërtuar kapacitetet e tyre të trajnimit (aftësitë e prezantimit, përgatitjen e materialeve të punëtorive, aftësitë e trajnimit etj.), përpara se të kalojnë tutje në aspektet më teknike që lidhen me luftën kundër TQNJ dhe mbrojtjes së viktimave. Rrjedhimisht, nevojitet ngritja e kapaciteteve përkatëse për KNAT /ZKNAT për të menaxhuar grupin e trajnerëve dhe për të mbajtur interesimin dhe angazhimin e tyre.

Sa i përket temave që duhet t'u shpërndahen trajnerëve që do të jenë në grupin e trajnerëve, duhet të përmendet se ato duhet të nxirren nga objektivat e strategjisë për të siguruar zbatimin e duhur të objektivave të përcaktuara më parë, por kryesisht duke u fokusuar në zbatimin e PSV-ve.

6. KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET

Zyra e KNAT u funksionalizua plotësisht në vitin 2005 dhe që atëherë është investuar shumë në ngritjen e kapaciteteve, të siguruara nga shumë organizata, por jo të qëndrueshme dhe duke mos adresuar nevojat afatgjata të Zyrës.

Ky VNT, siç përmendet më lart, ka identifikuar disa çështje që kanë nevojë për përmirësim në funksionimin e ZKNAT. Konkluzioni kryesor i arritur është nevoja për të ndërtuar kapacitetin e KNAT

/ ZKNAT (dhe në përputhje me rrethanat e akterëve të tjerë) në monitorim & vlerësim si dhe metodologjitë dhe mjetet për grumbullimin e të dhënave. Të gjithë akterët raportuan sfida në grumbullimin dhe shpërndarjen e të dhënave, si dhe në gjenerimin e raporteve të kualitetit që do të informonin përpjekjet e strukturuar dhe të koordinuara drejt parandalimit dhe luftimit të TQNJ. Mekanizmat e grumbullimit të të dhënave dhe korniza e M & V duhet të përmirësohen në mënyrë që të jenë në gjendje të monitorojnë punën e përgjithshme të Autoritetit Antitrafikim / palët e interesit dhe të bëjnë matjen e progresit duke përdorur treguesit e shprehur në aktivitetet e planifikuara të Planit të Veprimit 2015 - 2019 dhe më gjerë. Paralelisht me zhvillimin e mekanizmit të ri të M & V ekziston nevoja për të përmirësuar mekanizmin e mbledhjes së të dhënave, me qëllim që të shmangen sfidat në identifikimin e viktimave dhe përcjelljenj e viktimave që mund të trafikohen më shumë se një herë gjatë jetës së tyre.

Së dyti, mungesa e zhvillimit strategjik dhe aftësive për planifikim të veprimit kanë rezultuar në një Strategji Kombëtare që nuk ka objektiva dhe veprime të matëse dhe kështu vendosjen e caqeve dhe treguesve të strukturuar siç duhet.

Kjo sjell konkluzionet në pikën e tretë, lidhur me angazhimin dhe koordinimin e palëve të interesit në trajtimin e rasteve të trafikimit dhe zbatimin e punës antitrafikim.

E fundit por jo më nga rëndësia, për të siguruar zbatimin e duhur të MNR dhe PSV-ve, si dhe për të siguruar një ndikim afatgjatë dhe cilësi të shërbimeve të ofruara nga palët e interesit të cilat merren me luftën kundër trafikimit, ekziston nevoja për të ndërtuar një grup trajnerësh nacional përmes një trajnimi gjithëpërfshirës dhe të avancuar të Trajnimit të Trajnerëve që do t'i dorëzohet një grupi të përzgjedhur njerëzish të cilët do të bartin më tej me aftësitë dhe do të rrisin njohuritë e fituara. Pas vlerësimit të performancës së suksesshme të pjesëmarrësve gjatë trajnimit, duhet të sigurohet një certifikatë e pjesëmarrjes për validimin joformal të aftësive të fituara si trajner nacional të çertifikuar.

Natyrisht, kjo kërkon gjithashtu ngritjen e kapaciteteve të KNAT / ZKNAT për të menaxhuar grupin e trajnerëve dhe për të mbajtur interesimin dhe angazhimin e tyre. Ngritja e kapaciteteve të KNAT-it në përgjithësi propozohet të mbulohet përmes shërbimeve individuale të mentorimit dhe stërvitjes në vend pune se sa përmes trajnimit tradicional.

Sipas gjetjeve dhe konkluzioneve të lartpërmendura, bëhen këto rekomandime në vijim:

- Mbështetja e Sekretariatit të AT (ZKNAT) është i nevojshëm për të zhvilluar dhe menaxhuar mekanizmat për M & E në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Anti-Trafikimin / Planin e Veprimit - mbledhjen, analizimin, raportimin dhe shpërndarjen e informatave. Ngritja e kapaciteteve të KNAT në përgjithësi propozohet të mbulohet përmes shërbimeve individuale të mentorimit dhe trajnimeve gjatë implementimit të projektit në vend të trajnimeve tradicionale gjatë një periudhe të caktuar. Intensiteti dhe frekuenca e mbështetjes duhet të planifikohet në përputhje me detyrat e KNAT / ZKNAT në periudha të caktuara kohore.
- Mbështetja për ZKNAT është e nevojshme për të harmonizuar Mbledhjen e të Dhënave në mes të palëve të interesuara të Autoritetit Nacional Antitrafikim dhe për të krijuar mekanizma për të përmirësuar komunikimin dhe koordinimin.

- Strategjia ekzistuese dhe plani i veprimit ka nevojë për ristrukturimin e objektivave strategjike dhe treguesve. Sipas asaj që është tani, shumica e tyre nuk janë të matshëm dhe e bëjnë të vështirë për të monitoruar nëse zbatimi është i suksesshëm apo jo. Prandaj, një modul specifik trajnimi rekomandohet për ZKNAT për aftësitë dhe njohuritë e planifikimit strategjik në mënyrë që përpjekjet e ardhshme të planifikimit strategjik të ndjekin një metodologji dhe qasje të standardizuar dhe mirë të justifikuar.
- Ndërtimi i aftësive të menaxhimit të përgjithshëm dhe lidhshmërisht, veçanërisht lidhur me detyrat e koordinimit është i nevojshëm për funksionimin e qetë dhe të qëndrueshëm të ZKNAT dhe koordinimin me palët e interesit. Kjo përfshin gjithashtu ngritjen e kapaciteteve për të siguruar monitorimin dhe motivimin e duhur të grupit të trajnerëve.
- Ka nevojë për të mbajtur trajnime të akterëve kryesorë të përfshirë në Mekanizmin Nacional të Referimit (MNR) me qëllim të forcimit të reagimit institucional ndaj trafikimit të qenieve njerëzore, përmirësimit të zbatimit të PSV-ve dhe përmirësimit të koordinimit mes tyre, veçanërisht kur bëhet fjalë për menaxhimin e rasteve.
- Mekanizmi Transnacional i Referimit (MTR) duhet të përfshihet si një komponent e veçantë trajnimi.
- Për të siguruar zbatimin e duhur të MNR dhe PSV-ve, nevojitet një grup i qëndrueshëm i trajnerëve nacional. Ky grup i formuar i trajnerëve duhet të marrë rol qendror në trajnimin e mëtejshëm të akterëve lokalë dhe profesionistëve të përfshirë drejtpërdrejt ose tërthorazi në fushën e antitrafikimit. Një program specifik i Trajnimit të Trajnerëve duhet të zhvillohet posaçërisht për këtë grup të trajnerëve.

7. ANEKS 1: DRAFT PROGRAMI I TRAJNIMIT

Draft Modulet e Trajnimit				
A/A	Muaji	Palët (akterët)	Lloji i veprimit për NK	Moduli i Propozuar i Trajnimit
1	Tetor 2017*	KNAT/ZKNAT	Mentorim dhe trajnim individual 3-ditë Punëtori Trajnimi	Mekanizëm i ri për Monitorimin dhe Vlerësimin e Strategjisë Kombëtare dhe të Planit të Veprimit Antitrafikim 2015-2019
2	Tetor - Nëntor 2017*	KNAT/ZKNAT	Mentorim dhe trajnim individual	Zhvillimi i mjeteve të monitorimit për Kornizën e Monitorimit dhe Vlerësimin
3	Nëntor - Dhjetor 2017*	KNAT/ZKNAT	Mentorim dhe trajnim individual 2- ditë Punëtori Trajnimi	Nevojat për ndërtimin e kapaciteteve në Planifikim Strategjik (vendosja e objektivave të matshme, synimet, treguesit, aftësitë e planifikimit etj.)
4	Janar 2018*	KNAT/ZKNAT	Mentorim dhe trajnim individual 2- ditë Punëtori Trajnimi	Ngritja e kapaciteteve në menaxhim, udhëheqje dhe koordinimin e palëve të interesuara
5	Janar 2018*	KNAT/ZKNAT	Mentorim dhe trajnim individual 3- ditë Punëtori Trajnimi	Ngritja e kapaciteteve në mbledhjen e të dhënave (mbledhja, analizimi, raportimi dhe shpërndarja e informacionit) Të harmonizojë mbledhjen e të dhënave ndërmjet akterëve të Autoritetit Nacional Antitrafikim dhe të krijojë mekanizma për të përmirësuar komunikimin dhe koordinimin
6	Nëntor 2017- Janar 2018*	KNAT/ZKNAT	Mentorim dhe trajnim individual	Ngritja e kapaciteteve në menaxhimin e grupit të trajnerëve dhe mbajtja e nivelit të lartë të angazhimit të tyre
7	Mars- Qershor 2018*	Grupi i Trajnuesve	5 deri 10-ditë* Punëtori trajnimi *varësisht	Aftësitë bazike të Trajnimit të Tranerëve Trajtime bazike dhe të avancuara

				lidhur me AT.
8	Mars- Qershor 2018*	Palët/akterët	10- ditë Punëtori Trajnimi *	Trajnime multi-disiplinore në TQNJ Mekanizmi Nacional i Referimit - forcimi i përgjigjes institucionale ndaj trafikimit të qenieve njerëzore, rritja e zbatimit të PSV-ve dhe përmirësimi i koordinimit mes tyre, posaçërisht kur bëhet fjalë për menaxhimin e rasteve. Mekanizmi Transnacional i Referimit

* Mbështetje e vazhdueshme duhet për tu siguruar gjatë gjithë pjesës së mbetur të projektit deri në përfundim

** do të bëhen përpjekje për të rritur numrin e ditëve të parashikuara fillimisht në varësi të kursimeve të mundshme nga aktivitetet e tjera të trajnimit.

*** ofrimin (shpërndarjen) varësisht nga kursimet e mundshme nga aktivitetet e trajnimit në Kapitullin 2 dhe 3.